



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: rmuca@klsb.org.al; Web-site: www.klsb.org.al

Auditim performance:

“PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. POGRADEC, NË FURNIZIMIN ME UJË TË PIJSHËM TË KONSUMATORËVE DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË PËRDORURA”

Përmbledhje Ekzekutive

Në zbatim të planit vjetor 2013, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAT, etj.), ndërmori auditimin me temë “Performanca e Ujësjiellës-Kanalizime ShA, Pogradec”. Ky auditim u programua për t’u ushtruar në Bashkinë Pogradec dhe Ndërmarrjen UK, pasi këto janë institucionet që kanë përgjegjësi direkte në ofrimin e këtij shërbimi. Pas përfundimit të punës paraprake audituese u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren iu dërgua projekt-raporti i auditimit subjekteve dhe palëve të interesit. Raporti përfundimtar është hartuar pasi janë shqyrtuar observacionet dhe shpjegimet e dërguara nga institucionet e përfshira në këtë auditim si dhe pas konsultimeve me palët e interesit.

Në përfundim të auditimit, pasi Kryetari u njoh me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit i Departamentit të Auditimit të Performancës, mbi aktivitetin dhe cilësinë e kontrollit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, në mbështetje të nenit 9 dhe 16 të Ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me Ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000,

V E N D O S I:

I. Të miratojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në Ujësjiellës – Kanalizime Sh.A. Pogradec: “Për vlerësimin e performancës të Ujësjiellës – Kanalizime SH.A. Pogradec, në furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe largimin e ujërave të përdorura”.

II. Të miratojë rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkojë marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE.

Rekomandimi 1:

- ✓ Departamenti i Financës i UKP, të rrisë efciënsën e punës për kontribut parësor në programimin dhe realizimin e të ardhurave, administrimin e shpenzimeve, uljen e detyrimeve të papaguara dhe kostos.

- ✓ Në bashkëpunim, UKP me aksionerët të analizojnë gjetjen e mënyrës më të përshtatshme të mbledhjes së taksave nga pushteti vendor (konkretisht duke ndarë faturën e shitjes së ujit pijshëm dhe largimit të ujërave të përdorura nga taksat vendore).

Në vijimësi

Rekomandimi 2:

- ✓ Për auditimin e brendshëm të hartohen manuale, dokumente dhe formularë standart mbi mënyrën e raportimit, realizimit të objektivave dhe rekomandimeve.
- ✓ Në realizimin e auditimeve, aksionerët të përfshijnë audituesit e tyre, si dhe të auditohen sistemet e kontrollit të departamenteve dhe drejtorive të UKP.

Në vijimësi

Rekomandimi 3:

- ✓ Në shërbim të konsumatorëve dhe për arritjen e objektivave të saj, UKP të bëjë analiza mbi humbjet, me orientimin: humbjet teknike rrisin kostot ndërsa ato komerciale ulin të ardhurat, si dhe dokumentojë llogaritjet e tyre.
- ✓ Në bazë të përvojave më të mira, UKP e aksionerët e saj, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve Publike e Transportit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime, të hartojnë metodika edhe standarte në përcaktimin e nivelit të humbjeve si indikatorë kryesorë të performancës së shoqërisë.

Në vijimësi

Rekomandimi 4:

- ✓ UKP, në llogaritjen e tarifave si kusht i plotësimit të nevojave të konsumatorit, të analizojë metodologjinë e vlerësimit sa më të saktë të kostos së plotë të produktit dhe shërbimeve që ofron.
- ✓ Për uljen tarifave dhe rritjen e shërbimit ndaj konsumatorëve, të analizohet nga aksionerët në bashkëpunim me UKP, ecuria dhe përgjegjësitë e likuidimit të detyrimeve të kredisë.

Në vijimësi

Rekomandimi 5:

- ✓ UKP të përcaktojë në rregullore ose udhëzues, hartimin e formularëve standart për procedurat e lidhjeve të reja, ndjekjes së kërkesave dhe ankesave të klientëve si dhe të shkëmbejë rezultatet e monitorimeve për cilësinë e ujit të pijshëm me ISSH-Pogradec.

Në vijimësi

Rekomandimi 6:

- ✓ Të realizohen anketime me qëllim përmirësimin e raporteve qytetar, subjekte publike e jopublike si konsumator të shërbimeve të ofruara nga UKP dhe aksionerët e tij, për cilësinë e furnizimit me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të përdorura me synim rritjen e transparencës së menaxhimit dhe vlerësimit të performancës.

Në vijimësi

Grupi i Auditimit

Alfred Zylfi

Zamir Kurushi

Livan Hoxha

Bujar LESKAJ



Drejtori
Rinald Muça

Tiranë, Qershor 2013